



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 107, datë 28.07.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK
ONLINE TË SHITJEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në rregulloren “Për Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik”, të miratuar me vendimin nr. 3, datë 03.10.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI

Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik”, të miratuar me vendimin nr. 3, datë 03.10.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Në rregulloren “Për Regjistrin Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik”, të miratuar me vendimin nr. 3, datë 03.10.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 4, bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë vijon:

“Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të përdorë persona apo shoqëri të licencuara nga AMF si ndërmjetës dhe të identifikojë çdo punonjës që do të realizojë dhe raportojë shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike të instaluar në ambientet e Autoritetit.”

Pas paragrafit të fundit shtohet, paragrafi si më poshtë vijon:

“Polica e sigurimit identifikohet nëpërmjet numrit unik gjeneruar dhe lëshuar nga Regjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorike dhe printuar në hapësirën përkatëse të policës. Shitja nuk duhet të realizohet në rast se mungon numri unik.”

2. Në nenin 7, bëhen këto ndryshime:

Pas paragrafit të fundit shtohet, paragrafi si më poshtë vijon:

“Numri unik i gjeneruar nga Regjistri Online duhet të printohet në policën e sigurimit të detyrueshëm motorik. Raportimi i të dhënave duhet të kryhet në kohë reale dhe pa ndryshime të të dhënave të raportuara, në krahasim me ato të printuara në policën e sigurimit të detyrueshëm motorik.”

3. Në nenin 9, bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Rastet e evidentimit të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik të paidentifikuara në sistemin qendror, rastet me numër identifikimi të dubluar, rastet me numër identifikimi jo korrekt, rastet e verifikimit të ndryshimeve të të dhënave të raportuara në krahasim me ato të printuara, rastet e cënimit të sigurisë së sistemit, përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore në fushën e sigurimit dhe kësaj rregulloreje.”